



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2018-01

**Vendosi:** Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 24 shtator 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

Versioni i redaktuar publik i  
fletarrestimit për Hysni Gucatin

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**T'i dorëzohet**

Z. Hysni Gucati

**Unë, gjykatësi Nikola Giju, gjykatës i vetëm i Dhomave të Specializuara të Kosovës, i caktuar nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara sipas nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji");**

**Pasi kam marrë** prej Prokurorit të Specializuar "Kërkesë urgjente për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave në lidhje me to", shënuar me datë 22 shtator 2020;

**Në bazë të** nenit 39(3) dhe nenit 41(6) të Ligjit, rregullës 53 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe neneve 387, 388 dhe 392 të Kodit Penal të Kosovës 2019, nr. 06/L-074 ("Kodi Penal");

### **LËSHOJ NJË FLETARRESTIM PËR**

<b>HYSNI GUCATIN</b> (emri i babait [REDAKTUAR]), lindur më <b>30 mars 1967</b> në <b>Morinë, Skënderaj, Kosovë, NUMRI PERSONAL I IDENTIFIKIMIT</b> [REDAKTUAR], vendbanimi i fundit i njohur në [REDAKTUAR], Kosovë.
---

#### **1. Veprat penale dhe një përshkrim i shkurtër i fakteve**

1. Ekziston dyshim i bazuar se Hysni Gucati ("z. Gucati") është penalisht përgjegjës për orvatje të kryerjes së veprës penale të frikësimit gjatë procedimit penal në bazë të nenit 387 të Kodit Penal. Konkretisht, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati mbajti tri konferenca për shtyp më 7, 16 dhe 22 shtator 2020, ku ai shpërndau ose vuri në dispozicion të medias informacion dhe dokumente konfidenciale dhe jopublike që kanë lidhje me punën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe nuk bëri asnjë ndërhyrje kur Nasim Haradinaj përmendi me emër disa dëshmitarë (të mundshëm) dhe përmendi të dhëna në lidhje me vendbanimin e tyre dhe të dhëna të tjera

personale. Kjo sjellje përbën kërcënim të rëndë ose mënyrë tjetër shtrëngimi që e nxit një person të mos japë deklaratë ose të japë deklaratë të rreme, ose që të mos i japë informacion të vërtetë Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe/ose Dhomave të Specializuara.

2. Gjithashtu, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale të hakmarrjes sipas nenit 388 të Kodit Penal. Konkretisht, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati mbajti tri konferenca për shtyp më 7, 16 dhe 22 shtator 2020, ku ai shpërndau ose vuri në dispozicion të medias informacion dhe dokumente konfidenciale dhe jopublike që kanë lidhje me punën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ku përfshihen emra dhe të dhëna personale të dëshmitarëve (të mundshëm), duke i ekspozuar në këtë mënyrë këta individë me kërcënime të mundshme kundër sigurisë së tyre. Kjo sjellje përbën një veprim të dëmshëm me synimin e hakmarrjes për dhënien e informacionit të besueshëm Task Forcës Hetimore Speciale dhe/ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar në lidhje me pretendime për kryerje të veprave penale.

3. Gjithashtu, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale të shkeljes së fshehtësisë së procedurës sipas nenit 392 të Kodit Penal. Konkretisht, ekziston dyshim i bazuar se z. Gucati mbajti tri konferenca për shtyp më 7, 16 dhe 22 shtator 2020, ku ai shpërndau ose vuri në dispozicion të medias informacion dhe dokumente konfidenciale dhe jopublike që kanë lidhje me punën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ku përfshihen emra dhe të dhëna personale të dëshmitarëve (të mundshëm).

4. Ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se arrestimi i z. Gucati është i domosdoshëm për shkak se ekziston rreziku i arratisjes së tij, duke mbajtur parasysh: (i) vënien e tij në dijeni për veprat penale të pretenduara që përmenden në këtë fletarrestim dhe dënimet e mundshme në lidhje me këto vepra penale; (ii) fondet e konsiderueshme në dispozicion të tij si kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës

të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; (iii) mbështetjen e tij në një rrjet të gjerë përkrahësish ndër të cilët persona ekspertë në çështje të sigurisë, policisë dhe inteligjencës; dhe (iv) aftësinë e tij për të udhëtuar në mënyrë të ligjshme e të paligjshme në vende sipas juridiksionit të të cilëve nuk ekziston obligimi i transferimit në Dhomat e Specializuara.

5. Po ashtu, ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se arrestimi i z. Gucati është i domosdoshëm sepse rrethanat konkrete tregojnë se ai ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të penguar ecurinë e procedimit penal, duke marrë parasysh se: (i) ai shpërndau informacion dhe dokumente konfidenciale dhe jopublike që burojnë prej Task Forcës Hetimore Speciale dhe/ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar; (ii) bëri të ditur se do të vazhdojë të nxjerrë informacion konfidencial dhe jopublik dhe i nxiti anëtarët e mediave që të bëjnë nxjerrje të tilla të informacionit; dhe (iii) nxjerrja publike e një informacioni të tillë është bërë duke treguar një indiferencë të hapur për rreziqet e sigurisë me të cilat përballen dëshmitarë (të mundshëm) dhe me synim për të delegitimuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe Dhomat e Specializuara, të cilat ai nuk i njeh.

6. Gjithashtu, ekzistojnë arsye të besueshme për të besuar se arrestimi i z. Gucati është i domosdoshëm sepse rrethanat konkrete tregojnë se ai do të përsërisë, ose do të orvatet të kryejë përsëri veprat penale, duke marrë parasysh se ai e shprehu qartë synimin e tij për të vazhduar me nxjerrjen publike të informacionit dhe dokumenteve konfidenciale dhe jopublike në lidhje me dëshmitarë (të mundshëm) dhe hetime të Task Forcës Hetimore Speciale dhe/ose të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, duke provuar në këtë mënyrë se vazhdon të ekzistojë rreziku që ai të kërcënojë, frikësojë dhe të vërë në rrezik dëshmitarë (të mundshëm) përmes nxjerrjes së një informacioni të tillë.

## 2. Transferimi dhe objekti i paraburgimit

7. Në bazë të nenit 41(7) të Ligjit dhe rregullës 55(4) të Rregullores, në rast se z. Gucati arrestohet në Kosovë ose në një shtet të tretë, ai do të transferohet në objektin e paraburgimit që mbikëqyret prej Dhomave të Specializuara dhe që drejtohet prej Zyrës Administrative.

## 3. Të drejtat e z. Gucati

8. Në momentin e arrestimit, z. Gucati gëzon të drejtat në bazë të neneve 21, 38(3) dhe 41(4) të Ligjit, të cilat Zyra e Prokurorit të Specializuar duhet t'ia lexojë në momentin e arrestimit.

9. Z. Gucati do të sillet pa vonesë para gjykatësit të vetëm në bazë të nenit 41(5) të Ligjit.

10. Në momentin e arrestimit, z. Gucati ka të drejtë në bazë të nenit 41(2) dhe (5) të Ligjit, të kundërshtojë ligjshmërinë e arrestimit të tij, të urdhrit të transferimit dhe të kushteve të paraburgimit para gjykatësit të vetëm dhe ka të drejtë të apelojë para Dhomës së Specializuar të Gjykatës së Apelit.

## 4. Urdhra të tjerë

11. Fletarrestimi, aktualisht klasifikuar si konfidencial *ex parte*, mund t'u komunikohet, ose ekzistenca e tij mund t'u bëhet e njohur të dyshuarit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Kosovës ose të shteteve të treta, përfshirë shtetin pritës, nëse është e domosdoshme për zbatimin e fletarrestimit.

12. Duke mbajtur parasysh klasifikimin aktual të këtij fletarrestimi, gjykatësi i vetëm u kërkon autoriteteve kompetente të Kosovës ose të cilitdo shteti të tretë, sipas rastit që të mos ia bëjnë të njohur askujt ekzistencën dhe përmbajtjen e këtij fletarrestimi,

me përjashtim të personave angazhimi i të cilëve është absolutisht i domosdoshëm për zbatimin dhe dorëzimin e këtij fletarrestimi zotit Gucati.

13. Në qoftë se ndonjë subjekt, zyrtar i qeverisë së Kosovës ose ndonjë person tjetër në Kosovë pengon zbatimin e këtij fletarrestimi, kjo mund të përbëjë vepër penale sipas nenit 15(2) të Ligjit.

14. Në bazë të neneve 53(3) dhe 54(1) të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë përparësi ndaj të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë dhe ky fletarrestim ka të njëjtën fuqi ligjore si urdhrat e lëshuar nga gjykatat e tjera të Kosovës.

/nënshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i vetëm**

E enjte, 24 shtator 2020

Në Hagë, Holandë.